



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /
GOVERNMENT OF KOSOVA



Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo unutrašnjih poslova
Ministry of Internal Affairs

DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT

Inspektorati Policor i Kosovës
Policijski Inspektorat Kosova
Police Inspectorate of Kosovo

Raport Inspektimi Nr: 7/2014

VLERËSIMI I IMPLEMENTIMIT TË REKOMANDIMEVE TË IPK 2012-2013



(2014)

SHKURTESAT

IPK - Inspektorati Policor i Kosovës
PK - Policia e Kosovës
DPP- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
DI - Departamenti i Inspektimeve
DPK - Departamenti i Policisë Kufitare
DRPK - Drejtoria Rajonale e Policisë Kufitare
DRP - Drejtoria Rajonale Policore
DNJS - Drejtoria e Njësive Speciale
NJSO - Njësia Speciale Operative
NJSI - Njësia Speciale Intervenuese
NJRSH - Njësia e Reagimit të Shpejtë
KKSB - Këshillat komunale për siguri të bashkësisë
EVSB - Ekipet vepruese për siguri në bashkësi
KLSP - Komiteti lokal i sigurisë publike
ZDPO - Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Operativë
ZDPR - Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Resurse
DKRR-Departamenti i Komunikacionit Krugor
NJTR- Njësitë e Trafikut Rajonal
NJRKRR- Njësia Rajonale e Komunikacionit Krugor
DSHM- Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
IKSHPK - Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
PSO - Procedura Standarde e Operimit

PËRMBAJTJA

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	(4-5)
2. HYRJE	(6-6)
3. VERIFIKIMI SE CILAT NGA REKOMANDIMET E IPK-SË JANË IMPLEMENTUAR NGA PK-ja.....	(7-7)
3.1 Identifikimi dhe Vlerësimi i Procedurave të Arrestim- Ndalimit në PK.....	(8-9)
3.2 Ekzekutimi i Urdhëresave dhe Letërreshtimeve nga Policia e Kosovës -Stacioni Policor Gjakovë,	(9-10)
3.3 Menaxhimi i Policisë Kufitare,	(10-11)
3.4 Kryerja e Detyrave Policore në Planifikimin, Furnizimin, Mirëmbajtjen dhe Menaxhimin e Flotës Operative të Policisë së Kosovës,.....	(12-13)
3.5 Vlerësimi i Procedurave të Hetimit të Rasteve të Aksidenteve të Trafikut në Policinë e Kosovës	(13-14)
3.6 Vlerësimi i Shpërndarjes së Personelit në Policinë e Kosovës.....	(15-16)
3.7 Inspektimi i Performancës Policore së Njësive Speciale Operative.....	(16-17)
3.8 Vlerësimi i Kushteve Materiale dhe Aspektit të Sigurisë në Qendrat e Mbajtjes në Policinë e Kosovës,.....	(17-18)
3.9 Dhomat e Dëshmive në Policinë e Kosovës,.....	(19-20)
3.10 Vlerësimi i Performancës , Gatishmërisë, Trajnimeve dhe Kushteve të Punës në NJSI.....	(20-22)
4. VERIFIKIMI I PËRPJEKJEVE ORGANIZATIVE DHE PLANIFIKUESE NË DREJTIM TË IMPLEMENTIMIT TË REKOMANDIMEVE NGA MENAXHMENTI I LARTË I PK-SË.....	(23-23)
5. IDENTIFIKIMI SFIDAVE DHE PENGESAVE ME TË CILAT ËSHTË PËRBALLË PK-JA, NË DREJTIM TË IMPLEMENTIMIT TË REKOMANDIMEVE.....	(24-24)
6. PËRFUNDIMET.....	(25-26)
7. REKOMANDIMET.....	(27-28)

1. PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.1 Në bazë të nenit 24, paragrafi 2, të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK), IPK-ja ka ndërmarrë një inspektim të rregullt në Policinë e Kosovës (PK) lidhur me *“Vlerësimi i Implementimit të Rekomandimeve të IPK 2012-2013”*. Me autorizim të Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së, ky inspektim është zhvilluar për të përcjell implementimin e rekomandimeve nga Policia e Kosovës të dala nga raportet e inspektimeve në fushat inspektuara nga IPK-ja gjatë vitit 2012-2013.

1.2 Këtij Inspektimi përcjellës i ka paraprirë hartimi i programit inspektues duke përfshirë edhe përzgjedhjen e metodologjisë së punës. Programi inspektues ka paraparë fillimin e aktivitetit inspektues në terren me datë 23.04.2014 deri me 03.06.2014, dhe është zhvilluar në bazë të protokollit zyrtar të inspektimit, i cili ka përbajtur orarin dhe listën e intervistave që do të kryhen. Po ashtu si pjesë e programit inspektues ka qenë e përfshirë dhe metodologjia e veprimit në të cilën në mënyrë të veçantë është paraqitur qasja ndaj verifikimit të implementimit të rekomandimeve për secilën fushë të inspektuar.

1.3 Metodologjia e punës gjatë këtij inspektimi përcjellës të implementimit të rekomandimeve është realizuar në mënyrën të njëjtë sikur në kohën kur edhe janë zhvilluar inspektimet gjegjëse dhe janë dhënë rekomandimet (gjatë viteve 2012-2013), mirëpo madhësitë e mostrave që janë testuar gjatë këtij inspektimi përcjellës kanë qenë më të vogla në krahasim me periudhën inspektuese kur janë dhënë rekomandimet (2012 -2013).

1.4 Në përputhshmëri me rekomandimet nga fushat e inspektuara, IPK ka intervistuar zyrtarët policor që ishin përgjegjës për implementimin e atyre rekomandimeve, si dhe ka kontrolluar dosjet si masa testuese për të vërtetuar nivelin e implementimit të rekomandimeve.

1.5 Ky inspektim përcjellës i strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës bëhet për të siguruar se rekomandimet e IPK-së zbatohen dhe se implementimi i tyre sjell llogaridhënie, efikasitet dhe efektivitet në implementimin e ligjeve të aplikueshme, akteve nënligjore dhe procedurave tjera standarde të veprimit në fuqi si dhe për ngritjen e performancës së zyrtarëve policor në fushat inspektuara gjatë periudhës 2012-2013. Ky raport i inspektimit përfshinë të gjeturat dhe rekomandimet e dhëna për përmirësimin e gjendjes së gjetur në 10 inspektime të kryera gjatë viteve 2012-2013.

1.6 Qasja e prezantimit të të gjeturave në këtë raport është bazuar në rrethanat dhe sfidat që u janë krijuar PK-së, në implementimin e rekomandimeve që kanë dal nga IPK-ja. Kështu që të gjeturat në këtë raport janë prezantuar si të gjetura se cilat nga rekomandimet janë implementuar në plotësi, cilat rekomandime janë implementuar pjesërisht dhe cilat rekomandime nuk kanë arritur të implementohen fare.

1.7 Të gjeturat tregojnë se nga gjithsej dhjetë (10) inspektime nga periudha 2012-2013, të cilat ishin në fokus të këtij inspektimi përcjellës, prej të cilave kanë dal tetëdhjetë e katër (84) rekomandime, dyzetë e gjashtë (46) janë implementuar plotësisht, tridhjetë e gjashtë (36) janë implementuar pjesërisht kurse dy (2) prej tyre nuk kanë arritur të adresohen.

1.8 Lidhur me të gjeturat e paraqitura në këtë raport IPK me datë 12.12.2014 dhe 16.12.2014 ka mbajtur edhe takimin përmbyllës me menaxhmentin e PK-së. Në këtë takim janë diskutuar të gjitha detajet e paraqitura në raport. Me datën 30.12.2014 IPK-ja ka pranuar nga Menaxhmenti i lartë i PK-së komentet lidhur me të gjeturat e paraqitura në raport. IPK pas pranimit të komenteve të gjitha i ka inkorporuar në përmbajtjen e raportit.

2. HYRJE

2.1 Në bazë të Ligjit të Inspektoratit Policor të Kosovës Nr. 03/L-231, paragrafi 2, me autorizimin e Kryeshefit Ekzekutiv, Departamenti i Inspektimeve ka kryer Inspektim të rregullt në Policinë e Kosovës. Inspektimi u realizua nga inspektorët e Departamentit të Inspektimit dhe është zhvilluar nga data 23.04.2014 deri më 03.06.2014.

2.2 Qëllimi i organizimit dhe funksionalizimit të këtij inspektimi ka qenë që të bëhet verifikimi i implementimit të tetëdhjetekatër (84) rekomandimeve që kanë dal si rezultat i dhjete (10) inspektimeve të IPK-së të zhvilluara në periudhën kohore 2012 dhe 2013.

2.3 Objektivat që synon të arrij ky inspektim është që të bëhet:

- Verifikimi i implementimit të rekomandimeve të IPK-së nga PK-ja.
- Verifikimi që menaxhmenti i lartë i PK-së ka bërë përpjekjet e duhura organizative dhe planifikuese në drejtim të implementimit të rekomandimeve.
- Identifikimi se cilat ishin sfidat dhe pengesat me të cilat është përballë PK-ja, në drejtim të implementimit të rekomandimeve të IPK-së.

2.4 Periudha e Mbulimit në këtë fushë të inspektimit përfshinë periudhën prej 01.01.2012 deri më 31.12.2012 si dhe 01.01.2013 deri më 31.12.2013.

2.5 Dokumentet në vijim kanë qenë baza në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve gjatë vlerësimit të detyrave policore në drejtoritë gjegjëse:

- Ligji i Policisë së Kosovës
- Udhëzimet Administrative
- Procedurat Standarde të Veprimit

2.6 Ky inspektim përcjellës luan rol të rëndësishëm në:

- Ushtrimin e kontrollit tek menaxhmenti policor për tu siguruar se rekomandimet e IPK-së janë duke u implementuar nga PK-ja.
- Ngritjen e përgjegjësisë së menaxhmentit policor me qëllim të angazhimit maksimal për të jetësuar rekomandimet.

2.7 Metodologjia: Gjatë këtij inspektimi është aplikuar metodologji e punës e kombinimit të metodës intervistuese me menaxhmentin e lartë të policor dhe zyrtarët tjerë policor ndaj të cilëve në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthorët u janë adresuar rekomandimet si dhe me metodën e kontrollimit fizik të dokumentacionit apo dosjeve (në mënyrën e njëjtë kur janë kontrolluar në kohën e inspektimeve). Po ashtu pjesë e metodologjisë ka qenë edhe metoda e vëzhgimit, fotografimi i atyre çështjeve që kanë qenë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejt me rekomandimin.

3. VERIFIKIMI SE CILAT NGA REKOMANDIMET E IPK-së JANË IMPLEMENTUAR NGA PK-ja (2012-2013)

Inspektorati Policor i Kosovës gjatë vitit 2012 gjegjësisht gjatë vitit 2013, nga gjithsej dhjetë (10) inspektime të rregullta, të cilat janë objekt i këtij inspektimi përcjellës, ka dhënë tetëdhjetë e katër (84) rekomandime.

Inspektimet e realizuara gjatë periudhës kohore 2012-2013 të cilat janë objekt i këtij inspektimi përcjellës janë si më poshtë :

1. Identifikimi dhe Vlerësimi i Procedurave të Arrestim- Ndalimit në Policinë e Kosovës,
2. Ekzekutimi i Urdhërësave dhe Letër-rreshtimeve nga Policia e Kosovës -Stacioni Policor Gjakovë,
3. Menaxhimi i Policisë Kufitare,
4. Kryerja e Detyrave Policore në Planifikimin, Furnizimin, Mirëmbajtjen dhe Menaxhimin e Flotës Operative të Policisë së Kosovës,
5. Vlerësimi i Procedurave të Hetimit të Rasteve të Aksidenteve të Trafikut në Policinë e Kosovës.
6. Vlerësimi i Shpërndarjes së Personelit në Policinë e Kosovës
7. Inspektimi i Performancës Policore së Njësive Speciale Operative,
8. Vlerësimi i Kushteve Materiale dhe Aspektit të Sigurisë në Qendrat e Mbajtjes në Policinë e Kosovës,
9. Dhomat e Dëshmimeve në Policinë e Kosovës,
10. Vlerësimi i Performancës , Gatishmërisë, Trajnimeve dhe Kushteve të Punës në NJSI-së,

Të gjeturat tregojnë se nga gjithsej dhjetë (10) inspektime nga periudha 2012-2013, të cilat ishin në fokus të këtij inspektimi përcjellës, prej të cilave kanë dal tetëdhjetë e katër (84) rekomandime, dyzetë e gjashtë (46) janë implementuar plotësisht, tridhjetë e gjashtë (36) janë implementuar pjesërisht kurse dy (2) prej tyre nuk kanë arritur të adresohen.

Në vazhdim do të paraqesim numrin e rekomandimeve të realizuara plotësisht, pjesërisht dhe të pa implementuar për secilin inspektim veç e veç duke përcjell me komente lidhur me gjendjen si ishte dhe si është gjetur në kohen e këtij inspektimi përcjellës si dhe cilat janë reziqet dhe mundësitë për përmirësim në forme rekomandimi për të ardhmen.

3.1 Identifikimi dhe Vlerësimi i Procedurave të Arrestim- Ndalimit në Policinë e Kosovës

3.1.1 Të gjeturat nga inspektimi “Identifikimi dhe vlerësimi i procedurave të Arrestim - Ndalimit në Policinë e Kosovës” i cili ishte zhvilluar në vitin 2012, kishin treguar për një mori lëshimesh procedurale, ku dosjet me formularët e Arrestim- Ndalimit nuk kanë qenë të unifikuara, përmbajtja apo radhitja e tyre nuk është bërë në përputhje me PSO-të, si dhe disa nga hapësirat nuk ishin të plotësuara sipas kriterëve.

3.1.2 Duke u bazuar në të gjeturat e inspektimit “Identifikimi dhe vlerësimi i procedurave të Arrestim - Ndalimit në Policinë e Kosovës”, IPK kishte dhënë pesë (5) rekomandime për mënyrën e evitimit të këtyre lëshimeve. Gjatë këtij inspektimi përcjellës IPK konstaton se PK është angazhuar që të bëjnë përmirësime të dukshme të gjendjes që nga koha kur ishin dhënë këto rekomandime dhe se tani kemi respektim të plotë të PSO-së “Qendrat e mbajtjes”.

3.1.3 Gjatë këtij inspektimi përcjellës “Vlerësimi i implementimit të rekomandimeve të IPK-së 2012-2013”, mbi implementimin e rekomandimeve nga raporti i inspektimit “Identifikimi dhe vlerësimi i procedurave të Arrestim-Ndalimit në PK”, IPK ka përzgjedhjen e 12 stacione policore për inspektim, pra nga dy stacione policore në secilën Drejtori Rajonale të PK-së për të kryer testimet e mostrave të përzgjedhura. Gjithsej janë kontrolluar dyzetë e tre (43) formularë me ç’rast nga secila qendër e mbajtjes së inspektuar janë marrë nga tri (3) dosje (formularët e Arrestim-Ndalimit) me përjashtim të qendrës së mbajtjes në Prishtinë ku janë marrë dhjetë (10) dosje për kontrollim.

3.1.4 Të gjeturat tregojnë se, gjatë këtij inspektimi përcjellës është vërejtur se PK kishte ndërmarr hapat e nevojshëm në mënyrë që të arrijë implementimin e rekomandimeve të dala nga raporti i inspektimit “Identifikimi dhe vlerësimi i procedurave të Arrestim - Ndalimit në Policinë e Kosovës”. Nga gjithsejtë pesë (5) rekomandimet e dhëna, duhet theksuar se tri (3) nga to janë adresuar plotësisht, kurse dy (2) rekomandime janë adresuar pjesërisht.

3.1.5 Andaj, nga masa testuese e kontrollimit të dyzetë e tre (43) formularët të Arrestim - Ndalimit është vërejtur se dosjet me formularët e Arrestim-Ndalimit janë unike, por çështjet e radhitjes (përmbajtjes), si dhe plotësimi i të gjitha hapësirave në formularë ende nuk bëhet në përputhshmëri të plotë si kërkohet me PSO.

3.1.6 Për më tutje, nga gjithsej dyzetë e tre (43) formularë të kontrolluar tridhjetë e tetë (38) prej tyre nuk kanë përmbushur standardet nga objektivi i caktuar e që ka pasur të bëjë me kompletimin dhe harmonizimin e formularëve.

3.1.7 Vlen të theksohet që ndryshimi i Kodit të Procedurës Penale ka ndikuar edhe në ndryshimin e disa kompetencave të zyrtarëve policor dhe duke pas parasysh këto ndryshime në Kodin e Procedurës Penale, IPK ka konsideruar se të gjitha rekomandimet e dhëna të cilat kanë të bëjnë me plotësimin e këtyre formularëve janë konsideruar si rekomandime të adresuara plotësisht.

3.1.8 Kurse sa i përket angazhimit të menaxhmentit të PK-së në aspektin e kontrollit dhe inspektimit të gjendjes rreth kompletimit të dosjeve për personat e arrestuar në qendra të mbajtjes, Inspektorët nga zhvillimi i intervistave si dhe nga inspektimi fizik i dosjeve në qendrat e mbajtjes kanë konstatuar se: nga ana e menaxherëve të PK-së kryhen inspektime të tilla, mirëpo këto inspektime nuk shoqërohen me ndonjë raport apo ndonjë shpresë tjetër përmes së cilës do të përshkruheshin të gjeturat nga këto inspektime.

3.1.9 Mos funksionimi i kontrollit të brendshëm si mekanizëm preventivë mund të rezultojë me përsëritjen e mangësive sa i përket përfilljes së procedurave të arrestim - ndalimit. Kurse Radhitja (përmbajtja) jo e duhur e formularëve si dhe mosplotësimi i hapësirave të kërkuara do të shkaktonte jo efektivitet dhe jo efikasitet në detyrat e përditshme policore e të cilat në vargun e sistemit të drejtësisë do ti krijonin mundësitë e prodhimit të efekteve negative për shkak të mos përfilljeve procedurale.

Rekomandim nr. 1

IPK përshëndet të arriturat në implementimin e rekomandimeve të dhëna nga inspektimit "Identifikimi dhe vlerësimi i procedurave të Arrestim - Ndalimit në Policinë e Kosovës" dhe rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë që të vazhdoj të ketë prioritet veprime konkrete duke zhvilluar inspektime, në mënyrë që të mbajë nën kontroll çështjen e kompletimit-harmonizimit, plotësimit, përmbledhjes (radhitjes) së formularëve të Arrestim- Ndalimit përmes mekanizmave të mbikëqyrjes dhe kontrollit të brendshëm siç është zyra e Auditimit të Brendshëm, Inspektimit dhe njësitë tjera relevante.

3.2 Ekzekutimi i Urdhëresave dhe Letër-rreshtimeve nga Policia e Kosovës –Stacioni Policor Gjakovë

3.2.1 Të gjeturat nga inspektimi "Ekzekutimi i Urdhëresave dhe Letër rreshtimeve nga Policia e Kosovës – Stacioni Policor Gjakovë" tregojnë se Stacioni Policor Gjakovë ka ndërmarrë hapat e duhur për të adresuar rekomandimet që kanë dal nga raporti i inspektimit. Nga gjithsej pesë (5) rekomandime të dhëna nga IPK, katër nga to (4) janë adresuar plotësisht dhe një (1) është adresuar pjesërisht.

3.2.2 Të gjeturat nga inspektimi "Ekzekutimi i urdhëresave dhe letër-rreshtimeve nga Policia e Kosovës – Stacioni Policor Gjakovë" i cili është zhvilluar në vitin 2012, kishte treguar se gjatë takimeve në mes të zyrtarëve policor me zyrën qendrore për menaxhimin e lëndëve nuk janë mbajtur procesverbale në të cilat do të përshkruhej rrjedha dhe përmbajtja e takimit, nuk kishte ndonjë dokument të shkruar përmes së cilit do të dëshmohej aktiviteti i zyrtarëve policor lidhur me ekzekutimin e urdhëresave të gjykatave, kishte nevojë për ngritjen e nivelit të komunikimit në mes të njërive të stacionit policor si dhe kishte nevojë për një mbështetje më të madhe si në aspektin logjistik, teknik dhe operacional.

3.2.3 Duke u bazuar në të gjeturat e inspektimit "Ekzekutimi i Urdhëresave dhe Letër rreshtimeve nga Policia e Kosovës – Stacioni Policor Gjakovë", IPK kishte dhënë pesë (5) rekomandime për mënyrën e përmirësimit të gjendjes. Gjate këtij inspektimi përcjellës IPK konstaton se Stacioni Policor Gjakovë ka treguar një angazhim serioz në drejtim të implementimit të rekomandimeve duke i vënë theks përmirësimit të gjendjes në krahasim me gjendjen e konstatuar në vitin 2012.

3.2.4 Të gjeturat tregojnë se, Stacionit Policor në Gjakovë me sukses ka koordinuar takimet e rregullta të PK-së me Gjykatën Themelore në Gjakovë dhe Prokurorin Themelore në Gjakovë, takime të cilat janë përcjell me proces verbale. Po ashtu në kuadër të Stacionit Policor në Gjakovë ekziston një bashkëpunim dhe komunikim të mirë në mes të njësisë së hetimeve, njësisë patrulluese dhe njësisë tjera me njësinë për zbatimin e urdhëresave të prokurorisë dhe gjykatës. Vlen të theksohet se të gjitha aktivitetet e ndërmarra lidhur me zbatimin e urdhëresave nga prokuroria dhe gjykata pasqyrohen me statistika dhe raporte të rregullta.

3.2.5 Po ashtu Stacioni Policor Gjakovë ka krijuar evidenca lidhur me veprimet dhe aktivitetet e ndërmarra për ti kërkuar dhe arrestuar personat të cilët kanë qenë në kërkim. Gjithashtu zhvillohen edhe takime të rregullta me Zyrën Qendrore për Menaxhimin e Lëndëve, por në këto takime nuk mbahen procesverbale për dallim nga takimet me gjykata ku procesverbalet tani mbahen në mënyrë të rregullt.

3.2.6 Mungesat e dëshmimeve fizike, tek planifikimi dhe realizimi i takimeve me Zyrën Qendrore për Menaxhimin e Lëndëve, do ta bënte pak të besueshëm çështjen e angazhimeve të cilit do udhëheqës në PK si dhe do të lejonte keqinterpretime për çështjet e adresuara.

Rekomandim nr. 2

IPK përshëndet të arriturat në implementimin e rekomandimeve të dhëna nga inspektimit “Ekzekutimi i urdhëresave dhe letër-rreshtimeve nga Policia e Kosovës – Stacioni Policor Gjakovë” dhe rekomandon Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm për Operativë dhe Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm për Resurse të kenë prioritet formimin e grupeve të cilat do të japin propozimet përmes së cilave do të krijoheshin formularë (shkresa) të cilat do të adresonin në mënyrë konkrete rastet e takimeve dhe bashkëpunimeve në mes njësisë brenda PK-së, si dhe institucioneve tjera.

3.3 Menaxhimi i Policisë Kufitare

3.3.1 Të gjeturat nga inspektimi “Menaxhimi i Policisë Kufitare” i cili është zhvilluar në vitin 2012, kishte treguar për nevojën e angazhimit të menaxhmentit të Policisë Kufitare për përmirësimin e gjendjes në disa fusha, si: shpërndarja e personelit të bëhet konform strukturës organizative, plotësimi i zbrazëtirave në vijën komanduese me personel të graduar, unifikimi i standardeve të raportimit dhe mos lejimi i raportimit me standarde të ndryshme për njësit të cilat kryejnë punën e njëjtë.

3.3.2 Gjithashtu nevojë për angazhim më të madhe të menaxhmentit ka pas edhe sa i përket monitorimit apo kontrollit të kryerjes së detyrave nga ana e personelit, inspektimit rreth përdorimit, ruajtjes dhe mirëmbajtjes së armëve dhe pajisjeve tjera operative, pajisjen me trajnimet e nevojshme dhe të obligueshme duke përfshirë edhe trajnimin për ricertifikim për personelin duke përfshirë edhe personelin e graduar

3.3.3 Të gjeturat nga ky inspektim përcjellës “Vlerësimi i implementimit të rekomandimeve të IPK-së 2012-2013” tregojnë se Departamenti i Policisë Kufitare ka ndërmarrë hapat e duhur për të adresuar rekomandimet e dhëna nga IPK. Nga gjithsej dymbëdhjetë (12) rekomandime të dhëna, pesë (5) janë adresuar plotësisht, dhe shtatë nga to (7) janë adresuar pjesërisht.

3.3.4 Sa i përket standardeve të raportimit, të gjeturat e këtij inspektimi përcjellës tregojnë se në kuadër të Departamentit të Policisë Kufitare është arrit të bëhet unifikimi i formave të raportimit në të gjitha nivelet si në aspektin statistikor ashtu edhe në aspektin kohor. Gjithashtu në kuadër të standardeve të raportimeve paraqiten edhe të dhënat statistikore të kontrollimit të vijës së dytë nga Pikëkalimet Kufitare, gjë që ka qenë edhe rekomandim i veçantë nga IPK-ja.

3.3.5 Rekomandimet të cilat kanë arritur të adresohen pjesërisht në bazë të të gjitha dokumentimeve, ka ardhur si rezultat i sfidave dhe angazhimeve të një shtrirje më të madhe strukturore në PK, duke mos u pozicionuar vetëm tek Departamentit i Policisë Kufitare apo i drejtorive rajonale policore. Kështu që shpërndarja e personelit në pajtim me strukturën organizative, ka paraqitur sfidë për tërë PK-në. Por, duhet theksuar se në kohën e zhvillimit të inspektimit, në PK ka qenë në zhvillim procesi i gradimit për Rreshter, me ç rast pas përfundimit të të gjitha proceseve do të arrihet të bëhet plotësimi i hapësirave në përputhje me strukturën organizative.

3.3.6 Gjithashtu për shkak të rrethanave objektive drejtoritë e policisë kufitare nuk kanë arritur që të përfillin obligimin që del nga PSO “Ushtrimi i Policimit në Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit” (DA/DPK-002/09) me të cilin një tog patrullues nuk duhet të ketë më shumë se 20-30 km nën mbikëqyrje. Departamenti i Policisë Kufitare nuk ka arrit siguroj funksionim të njëjtë në të gjitha Drejtoritë Rajonale të Policisë Kufitare, e cila gjë vihet në pah tek mbajtja e takimeve me KKSB, EVSB, KLSP dhe shoqërinë civile, organizimin e inspektimeve të aktiviteteve operative dhe të shfrytëzimit të pajisjeve operative të zyrtarëve policor. Gjithashtu kishte dallime edhe sa i përket prezantimit të të dhënave rreth planifikimit dhe realizimit të trajnimit të ricertifikimit.

3.3.7 Vlen të theksohet që PK konkretisht Departamenti për Burime Njerëzore është angazhuar në ofrimin dhe mbajtjen e trajnimeve për DPK, lidhur me nivelin e mesëm dhe të lartë menaxheria, duke siguruar programe të trajnimeve për pozitën e nivelit të mesëm dhe të lartë menaxheria të policisë kufitare.

3.3.8 Dallimet në mes adresimit të rekomandimeve nga ana e tri drejtorive rajonale kufitare, do të shkakton jo standardizim (unifikim) të çështjeve të ndryshme në mbajtje të kontrollit nga ana e Departamentit për Kufi si nivel që ka në mbikëqyrje të drejtpërdrejt të saj tri drejtoritë rajonale policore.

Rekomandim nr. 3

IPK përshëndet të arriturat në implementimin e rekomandimeve të dhëna nga inspektimit “Menaxhimi i Policisë Kufitare” dhe rekomandon Udhëheqësin e Departamentit për Kufi dhe udhëheqësin e Divizionit i Kontrollit dhe Mbikëqyrjes të Kufirit që të vënë në prioritet që adresimi i rekomandimeve të përcillet në mënyrën e njëjtë në të gjitha drejtoritë rajonale të policisë kufitare.

3.4 Kryerja e Detyrave Policore në Planifikimin, Furnizimin, Mirëmbajtjen dhe Menaxhimin e Flotës Operative të Policisë së Kosovës

3.4.1 Inspektimi i kryer në vitin 2012 “Kryerja e detyrave policore në planifikimin, furnizimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e Flotës Operative të Policisë së Kosovës”, kishte gjetur mjaftë hapësira për përmirësimin e gjendjes në flotën operative, pasi që ishin vërejtur se kishte zbrazëtira në pozita mbikëqyrëse, kishte mungesë të trajnimeve profesionale për personelin operativ, nuk kishte procedura të qarta rreth përcaktimit dhe vendosjes së kriterëve për servisimin të automjeteve në kompanitë e kontraktuara, nuk kishte të përcaktuar person përgjegjës për inspektimin dhe vlerësimin e automjeteve etj.

3.4.2 Duke u bazuar në të gjeturat e këtij inspektimi, IPK kishte dhënë dymbëdhjetë (12) rekomandime për mënyrën e përmirësimit të gjendjes së gjetur.

3.4.3 Të gjeturat e këtij inspektimi përcjellës për implementimin e rekomandimeve nga inspektimi “Kryerja e detyrave policore në planifikimin, furnizimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e flotës operative të PK-së” tregojnë se Departamenti për Shërbime Mbështetëse së bashku me Departamentin për Burime Njerëzore kanë ndërmarrë disa hapa me qëllim të adresimit të rekomandimeve të dhëna nga IPK-ja. Andaj, si rezultat i këtyre angazhimeve PK ka arrit që nga gjithsej dymbëdhjetë rekomandime (12), shtatë (7) nga to ti adresojë plotësisht, kurse pesë (5) nga to ti adresojë pjesërisht.

3.4.4 Për detaje më të hollësishme Inspektorët e IPK-së, gjatë inspektimit kanë arrit të sigurojnë dokumentacione të cilat dëshmojnë se menaxhmenti i lartë kishte ndërmarr hapa konkret për implementimin e rekomandimeve të dhëna nga IPK. Pra, është arrit që të mbulohen me personel përgjegjës pozitat e pambuluara, të organizohen trajnime për personelin e Flotës Operative në fushën e mekanikës, të bëhet planifikimi për furnizim me pjesë rezervë për automjete, të caktohen personat përgjegjës për inspektimin e automjeteve. Gjithashtu duhet theksuar se është arrit një përparim i theksuar edhe sa i përket mos tolerimit të vonësive në furnizime nga ana e operatorëve ekonomik.

3.4.5 Ndërsa sa i përket rekomandimeve të cilat janë implementuar pjesërisht Departamenti për Shërbime Mbështetëse, është angazhuar në drejtim të implementimit të tyre, mirëpo për shkak të implikimeve dhe ndryshimeve në infrastrukturën ligjore të institucioneve tjera nuk ka arritur ti adresojë plotësisht.

3.4.6 Kështu që në Flotën Operative regjistrimi dhe menaxhimi i pasurisë bëhet në data bazën e quajtur ROAD-bazë, e cila konsiderohet si regjistër kontabël i organizatës. Mirëpo Flota operative nuk ka arritur që regjistrin kontabël ta bëjnë në sistemin E-pasuria në përputhje me Udhëzimin Administrativ 02/2013. Flota Operative ka arritur që të bëjë kontrollim teknik periodik vetëm për automjetet e transportit (autobusët), por jo edhe të gjitha veturat. Po ashtu është dokumentuar se ka pasur angazhime në drejtim të licencimit të kontrollit teknike në flotën operative por që ende nuk ka arritur të finalizohet.

3.4.7 Kurse sa i përket ripërtëritjes së Flotës Operative me automjete të reja, të gjeturat nga inspektimi tregojnë se edhe këtu ka ngecje, megjithëse vërehet se kishte një angazhim të theksuar nga ana e menxhmentit për hartimin e politikave dhe planifikimit për ripërtëritjen e

flotës. Mirëpo për shkak të procedurave të prokurimit nuk është arrit të finalizohet ky planifikim. Gjithashtu nuk ka munguar angazhimi i menaxhmentit të Flotës Operative sa i përket përcaktimit të personave përgjegjës për vendim marrje lidhur me vendosjen se cilat automjete mundë të shkojnë në kompanitë private për riparim, si dhe kanë arrit që lidhur me këtë çështje ta përfundojnë rishikimin e PSO-së për Flotën Operative. Sa i përket uljes së trendit të aksidenteve të trafikut ku janë të involvuara automjetet e PK-së duhet theksuar se është arrit një rezultat në uljen e aksidenteve me automjete zyrtare të PK-së, mirëpo ende ka hapësirë për përmirësimin e kësaj gjendje.

3.4.8 Automjetet e vjetruara dhe mos funksionalizimi i kontrollës teknike të automjeteve policore pranë flotës operative do të rrisë shpenzimet e buxhetit.

Rekomandim nr. 4

IPK përshëndet të arriturat në implementimin e rekomandimeve të dhëna nga inspektimit 2012 “Kryerja e detyrave policore në planifikimin, furnizimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e Flotës Operative të Policisë së Kosovës” dhe rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë të vazhdoj të ketë si prioritet që Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse, të ndërmarrë hapat konkret me qëllim të furnizimit të PK-së me automjete të reja, të bëjë funksional kontrollin teknik në flotën operative si dhe të sigurohet që infrastruktura ligjore që rregullon çështjen e kontrollës teknike të jetë e zbatueshme.

3.5 Vlerësimi i Procedurave të Hetimit të Rasteve të Aksidenteve të Trafikut në Policinë e Kosovës

3.5.1 Të gjeturat nga inspektimi “Vlerësimi i procedurave të hetimit të rasteve të aksidenteve të trafikut në Policinë e Kosovës” i cili është zhvilluar në vitin 2012, kishte treguar për një mori lëshimesh procedurale gjatë plotësimit apo kompletimit të dosjeve të aksidenteve të trafikut, ku kishte raste kur deklarata e të dyshimitit për shkaktimin e aksidentit apo edhe deklarata e viktimës/dëshmitarit nuk ishin të nënshkruara, plotësimi i raportit standard të aksidentit të trafikut nuk ishte i plotësuar në të gjitha rubrikat e parapara, dosja e aksidentit nuk ishte e kompletuar me të gjithë formularët e nevojshëm, kishte mangësi edhe sa i përket menaxhimit të vendit të aksidentit dhe të paraqitjes skematike të vendit të aksidentit duke përfshirë përshkrimin e fotografive. Vlen të potencohet se NJTR-të (tani NJRKRR-të) nuk kishin ndonjë akt nënljor (PSO) unik ku do të bëhej përshkrimi i detaj detyrave dhe përgjegjësive të NJTR-ve.

3.5.2 Duke u bazuar në të gjeturat e këtij inspektimi “Vlerësimi i procedurave të hetimit të rasteve të aksidenteve të trafikut në Policinë e Kosovës” i cili është zhvilluar në vitin 2012, IPK kishte dhënë gjashtë (6) rekomandime për mënyrën e përmirësimit të gjendjes së gjetur.

3.5.3 Të gjeturat nga ky inspektim përcjellës për implementimin e rekomandimeve të dhëna nga inspektimi “Vlerësimi i Procedurave të Hetimit të Rasteve të Aksidenteve të Trafikut në PK” tregojnë se Policia e Kosovës gjegjësisht Divizioni i Komunikacionit Rrugor dhe NJRKRR-të kanë ndërmarrë disa hapa për të adresuar rekomandimet e IPK-së. Kështu që nga gjithsej gjashtë (6) rekomandime katër (4) prej tyre i ka adresuar plotësisht, dy (2) nga to i ka adresuar pjesërisht.

3.5.4 Nga analizimi i dokumentacionit të marr gjatë këtij inspektimi përcjellës del se menaxhmenti i DKRR-së, më datë 14.11.2014, ka arrit që të bëjë unifikimin e PSO-ve për NJRKRR-të. Sa i përket implementimit të rekomandimeve që kanë të bëjnë me plotësimin e dosjeve të hetimit të aksidenteve nga ana e NJRKRR-ve Prizren dhe Mitrovicë, mundë të konsiderojmë se ky rekomandim është adresuar plotësisht, pasi që të gjeturat nga inspektimi tregojnë se dosjet e hetimeve të aksidenteve në këto dy NJRKRR janë të kompletuara. Gjithashtu të gjeturat nga inspektimi tregojnë se është adresuar plotësisht edhe rekomandimi lidhur me vendosjen e Stemës së Republikës së Kosovës në të gjitha dokumentet dhe formularët që dalin nga DKRR.

3.5.5 Duhet theksuar që në këtë inspektim është bërë kontrollimi i rasteve penale të Aksident-Trafikut në metodologjinë e njëjtë sikur në inspektimin e rregullt në vitin 2012. Në përputhshmëri me këtë metodologji kanë rrjedhur dhe rezultatet e gjendjes së rasteve të cilat punohen nga ana e NJRKRR-ve. Kështu që rekomandimet e adresuara pjesërisht janë ndërlidhur me përpilimin dhe plotësimin e dokumenteve (Raportit Standard të Trafikut Rrugor) e cila çështje nuk varet nga ndonjë rrethanë e pengesave apo sfidave me të cilat do të kishte mundësi të ndeshesh PK. Po ashtu DKRR nuk ka arrit plotësisht që të bëjë rishikimin e raportit standard të aksidenteve në Trafikun Rrugor.

3.5.6 Një angazhim më i madh vërehet sa i përket menaxhimit të aksidenteve duke përfshirë shikimin e vendit të aksidentit si dhe plotësimin e dosjes së aksidentit me formularët dhe deklaratat e nevojshme. Me gjithë angazhimin më të madh në këtë fushë edhe këtu vërehen disa mangësi si: mos përkrahimi i fotografive nga vendi i ngjarjes, mos aplikimi i kontrollit për alkooltest dhe substanca narkotike. Duhet theksuar se nga nëntëmbëdhjetë (19) raste të kontrolluara, pesëmbëdhjetë (15) prej tyre nuk kanë pasur përkrahime të fotografive nga vendi i ngjarjes. Ndërsa në gjashtëmbëdhjetë (16) nga ato raste pjesëmarrësve të përfshirë në aksident nuk kanë dëshmuar se ju kanë nënshtruar alkool-testit.

3.5.7 Mos unifikimi (standardizimi) i dokumenteve apo shkresave që dalin nga njësitë e njëjta, do të shkaktojë mos efikasitet në kryerjen e detyrave të përditshme në të gjitha Njësitë Rajonale të Komunikacionit Rrugor, duke bërë që qasja e çfarëdo problematike, të prodhojë diferenca në mes njërive brenda NJRKRR-ve. Po ashtu mos plotësimet e disa prej çështjeve që kërkohen në dokumentet e një rasti të aksidenteve do të ndikonte në performancën jo të mirë të NJRKRR-ve.

Rekomandim nr. 5

IPK përsëritet të arriturat në implementimin e rekomandimeve të dhëna nga inspektimi "Vlerësimi i procedurave të hetimit të rasteve të aksidenteve të trafikut në Policinë e Kosovës" dhe rekomandon Udhëheqësit e Divizionit të Komunikacionit Rrugor, komandantët e NJRKRR-ve, të kenë në prioritet angazhimin e tyre në përpilimin e dokumenteve të cilat do të dalin si të unifikuara, si dhe do të realizojnë një kontroll më të rreptë sa i përket kompletimit të të gjithë dosjes së rasteve të punuara nga zyrtarët policorë të NJRKRR-ve.

3.6 Vlerësimi i Shpërndarjes së Personelit në Policinë e Kosovës

3.6.1 Të gjeturat nga inspektimi “Vlerësimi i Shpërndarjes së Personelit në Policinë e Kosovës” i cili ishte zhvilluar në vitin 2012, kishte treguar për një mori problematikash (sfida) me të cilat ballafaqohet PK-ja lidhur me shpërndarjen e personelit. Gjatë këtij inspektimi ishte vërejtur se për shpërndarjen e personelit nuk ishte marrë për bazë kriteri i numrit të banorëve për zonën e përgjegjësisë, mandej, ka pas raste kur nuk ka qenë mjaftë e qartë vija ndarëse e zonës së përgjegjësisë në mes të stacioneve policore. Nuk kishte të hartuar ndonjë dokument i cili në vete do të ngërthente grup rregullash sistematike dhe të kodifikuara përmes së cilave do të dalin udhëzime të qarta se si do të trajtoheshin burimet njerëzore dhe shpërndarja e personelit në organizatë. Gjithashtu duhet theksuar se PK-ja ballafaqohet edhe me mungesë personeli siç ishte rasti me Drejtorinë për Sigurimin e Objekteve dhe Personave me Rëndësi të Veçantë, apo edhe me mungesën e personelit të graduar, mungesë kjo që kishte shkaktuar edhe shkëputje të zinxhirit komandues në aspektin e gradave.

3.6.2 Duke u bazuar në të gjeturat e këtij inspektimi “Vlerësimi i Shpërndarjes së Personelit në Policinë e Kosovës” i cili ishte zhvilluar në vitin 2012, IPK kishte dhënë gjashtë (6) rekomandime për mënyrën e tejkalimit të këtyre vështirësive.

3.6.3 Të gjeturat nga inspektimi përcjellës lidhur me implementimin e rekomandimeve nga raporti i inspektimit “Vlerësimi i Shpërndarjes së Personelit në PK” tregojnë se: Policia e Kosovës ka ndërmarrë disa hapat të nevojshëm për të adresuar rekomandimet që kanë dalë nga inspektimi për vlerësimin e shpërndarjes së personelit në PK. Nga gjithsej gjashtë (6) rekomandime të dhëna nga IPK, tri (3) nga to janë adresuar plotësisht, kurse tri (3) nga to kanë arritur të adresohen pjesërisht.

3.6.4 Duke ju falënderuar bashkëpunimit të mirë ndër-institucional me Entin e Statistikave të Kosovës si dhe Kuvendet Komunale, PK ka arrit që të siguroj të dhënat statistikore lidhur me numrin e popullsisë. Gjithashtu është arrit të sigurohen të dhëna nga Drejtoritë për Gjeodezi dhe Kadastër lidhur me kufijtë e zonës së përgjegjësisë së komunave e cila lidhet drejtpërdrejt me zonën e përgjegjësisë së stacioneve policore.

3.6.5 Ndërsa në implementimin e pjesërisht të rekomandimeve ka ndikuar një sërë rrethanash dhe të cilat zakonisht reflektojnë tek organizatat e mëdha në përgjithësi e në veçanti tek çështjet e burimeve njerëzore.

3.6.6 Kështu që Policia e Kosovës përmes shpalljes së konkurseve të brendshme, organizimeve të trajnimeve ka hapur rrugë drejt plotësimin të nevojave për personel me gradat e nevojshme, ku pas përfundimit të këtij procesi do të bëhet shpërndarja e personelit në përputhshmëri me strukturën organizative në fuqi. Sa i përket funksionimit të data – bazës unike, vlen të potencohet se është krijuar data-baza e re “SIPK-u i ri” e cila është një data-bazë e avancuar dhe nga e cila do të mundë të kemi të dhëna statistikore unike. Por, në proces të implementimit është edhe sistemi “PRIMS” i cili mund të integrohet (ndërlidhet) me sistemin e SIPK-ut, me ç’rast mund të konsiderohet se në të ardhmen e afërt do të kemi një data-bazë gjithëpërfshirëse dhe unike. Ndërsa PK ka krijuar një mori dokumente të cilat trajtojnë burimet njerëzore dhe shpërndarjen e tyre në organizatë, por që nuk është arritur të hartohet ndonjë dokument i cili do të përfshinte grup rregullash të sistematizuara dhe kodifikuara të cilat do të

udhëzozin qartë fillimisht trajtimin e burimeve njerëzore dhe më pastaj shpërndarjen e tyre në organizatë.

3.6.7 Shkëputjet zinxhirore të gradave, të dhënat (statistikat) e ndryshme, do të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejt në aspektin e përgjegjësive, llogaridhënies, dhe performacës në të gjitha nivelet e udhëheqjes së PK-së.

Rekomandim nr. 6

IPK përshëndet të arriturat në implementimin e rekomandimeve të dhëna nga inspektimi “Vlerësimi i Shpërndarjes së Personelit në PK” dhe rekomandon Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë që të vazhdojë ta ketë prioritet çështjen e shpërndarjes së personelit e cila duhet të bëhet në përputhshmëri të plotë me rregulla të qarta të shpërndarjes së personelit ekzistues. Ndërsa, drejtorët e departamenteve duhet të angazhohen duke kontribuar në dhënien e ideve dhe zhvillimin e bashkëpunimit me të gjitha njësitë për të mundësuar krijimin e një data baze e cila në mënyrë të unifikuar do të prezantonte të dhënat e të gjitha niveleve të PK-së.

3.7 Inspektimi i Performancës Policore së Njërive Speciale Operative

3.7.1 Të gjeturat nga inspektimi “*Inspektimi i performancës Policore së Njërive Speciale Operative*” i cili ishte zhvilluar në vitin 2013, kishte treguar se në kuadër të NJSO-ve nuk ishin të plotësuara të gjitha pozitat me personelin e graduar konform strukturës organizative, nuk kishte një formë unike për të gjitha regjionet për regjistrimin e armëve dhe pajisjeve tjera si dhe mungesa e sigurimit shëndetësor për personelin e NJSO-së. Gjithashtu nga ky inspektim ishte paraqitur si nevojë rishikimi i PSO-së që rregullon punën e NJSO-së, dhënia e kontributit të NJSO-së për formimin e NJRSH-ve, përcaktimi i prioritetëve për trajnimet themelore, organizimi dhe mbajtja e rregullt të trajnimeve të ricertifikimit si dhe organizimi i testimit vlerësues për njohurit e fituara gjatë trajnimeve.

3.7.2 Duke u bazuar në të gjeturat e këtij inspektimi “*Inspektimi i performancës Policore së Njërive Speciale Operative*” i cili ishte zhvilluar në vitin 2013, IPK kishte dhënë tetë (8) rekomandime për mënyrën e përmirësimit të gjendjes së gjetur.

3.7.3 Të gjeturat nga ky inspektim përcjellës mbi implementimin e rekomandimeve nga raporti i inspektimit “*Inspektimi i performancës Policore të Njërive Speciale Operative*”, tregon se menaxhmenti i lartë i PK-së konkretisht menaxhmenti i lartë i Departamentit për Operacione në bashkërendim me menaxhmentin e Divizionit të Njërive të Specializuara kanë ndërmarrë masat e nevojshme me qëllim të implementimit të rekomandimeve që kanë dal si rezultat i të gjeturave nga inspektimi në fushën gjegjëse. Kështu që nga gjithsej tetë (8) rekomandime gjashtë (6) nga to janë adresuar plotësisht, një (1) nga to është adresuar pjesërisht dhe një (1) nuk është adresuar.

3.7.4 Gjatë inspektimit në DNJS si dhe gjatë zhvillimit të intervistave me menaxhmentin e DNJS-së është konstatuar se procesi i centralizimit të NJSO-ve kishte përfunduar, duke u përqendruar si një njësi në nivelin e përgjithshëm vendor të vendosur në të “Kampin Vrella”. Mirëpo duhet theksuar se për nevoja operative një tog i NJSO-së vepron në Mitrovicë (NJSO-Belvederë).

3.7.5 Sa i përket themelimit të NJRSH-ve në kuadër të Drejtorive Rajonale, duhet theksuar se ky proces ka përfunduar me mjaft sukses duke përfshirë edhe Drejtorinë Rajonale Mitrovica - Veri. Gjithashtu duhet theksuar se themelimi i NJRSH-ve është i shoqëruar edhe me trajnimet adekuate si dhe me aktet e nevojshme rregullative (PSO-të).

3.7.6 Të gjeturat nga inspektimi tregojnë për rezultate inkurajuese sa i përket trajnimit të ricertifikimit për zyrtarët e NJSO-së si dhe në organizimin e testimeve për aftësitë, njohuritë dhe shkathtësitë e këtyre zyrtarëve. Gjithashtu vlen të theksohet se në kuadër të NJSO-së me rregull kryhen procesi i regjistrimit dhe inventarizimit për armët dhe pajisjet që posedon kjo njësi.

3.7.7 Ndërsa implemtimi i pjesërishëm apo i pa adresuar i rekomandimeve ka ardhur si rezultat i disa rrethanave objektive dhe implikimeve të infrastrukturës ligjore që rregullohen nga institucione tjera. Kështu që NJSO-të, kanë arritur që pjesërisht të implemtojnë rekomandimin lidhur me plotësimin e pozitive me gradat adekuate, por ende nuk kanë arritur të evitojnë diferencat lidhur me shtrirjen e kontrollit.

3.7.8 Shkëputjet zinxhirore në nivelin gradave mund të lënë hapësira çështjeve që kanë të bëjnë me përgjegjësitë, si dhe të ndikojë drejtpërdrejt në efikasitetin dhe efektivitetin e NJSO-së. Kurse mos zbatimi i rregullave të caktuara ligjore (ligji për sigurimet shëndetësore) mund të shkaktojë pasoja, të cilat mund të përcillen në mënyrë zinxhirore brenda organizatës dhe jashtë saj.

Rekomandim nr. 7

IPK përshëndet të arriturat në implementimin e rekomandimeve të dhëna nga inspektimi *“Inspektimi i performancës Policore së Njërive Speciale Operative”* dhe rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë të vazhdoj të ketë si prioritet që burimet njerëzore me të cilat posedon e të cilat i përmbushin nevojat e shpërndarjes së tyre të bëhen në përputhshmëri me gradat dhe trajnimet adekuate.

3.8 Vlerësimi i Kushteve Materiale dhe Aspektit të Sigurisë në Qendrat e Mbajtjes në Policinë e Kosovës

3.8.1 Të gjeturat nga inspektimi *“Vlerësimi i kushteve materiale dhe aspektit të sigurisë në qendrat e mbajtjes në Policinë e Kosovës”* i cili ishte zhvilluar në vitin 2013, kishte treguar për mungesë të kushteve të punës për personelin që punojnë në qendrat e mbajtjes, ku ballafaqoheshin me mungesë të hapësirës së mjaftueshme në dhomat e monitorimit si dhe me mungesën e sirtarëve të veçante për ruajtjen e gjësendeve të marra nga personat e ndaluar. Mungesë të kushteve kishte edhe në vetë dhomat e mbajtjes, ku mungonin muret ndarëse të tualeteve të cilët do të siguronin privatësinë për personat e ndaluar, pastërtia e dritareve nuk ishte në nivelin e kënaqshëm, grilat e dritareve ishin të dëmtuara si dhe sistemi i kamerave për monitorim nuk ishte plotësisht funksional. Gjithashtu në disa qendra të mbajtjes nuk kishte plan të evakuimit për rastet emergjente për personat e arrestuar.

3.8.2 Duke u bazuar në të gjeturat e këtij inspektimi “Vlerësimi i kushteve materiale dhe aspektit të sigurisë në qendrat e mbajtjes në Policinë e Kosovës” i cili ishte zhvilluar në vitin 2013, IPK kishte dhënë dhjetë (10) rekomandime për mënyrën e evitimit të këtyre mangësive.

3.8.3 Të gjeturat nga ky inspektim përcjellës mbi implementimin e rekomandimeve nga inspektimi “Vlerësimi i kushteve materiale dhe aspektit të sigurisë në qendrat e mbajtjes në Policinë e Kosovës” tregon se Policia e Kosovës ka ndërmarrë hapat e nevojshëm drejt implementimit të rekomandimeve të dhëna. Andaj, nga gjithsej dhjetë (10) rekomandime, tri (3) nga to i ka adresuar plotësisht, kurse pjesërisht ka adresuar shtatë (7) prej tyre.

3.8.4 Duhet theksuar se të gjeturat e inspektimit përcjellës për vlerësimin e implementimit të rekomandimeve tregojnë se rekomandimet e dhëna nga IPK për të cilat nuk kishte implikime buxhetore si dhe procedura të prokurimit janë implementuar plotësisht. Pra, niveli i pastërtisë së dritareve ishte i mirë si dhe janë hartuar planet e evakuimit në nivel të qendrave të mbajtjes. Mirëpo, duhet theksuar se kemi edhe rekomandime për të cilat nuk ka implikime buxhetore, por të cilat nuk kanë arrit të adresohen plotësisht, siç ishte rasti me rekomandimin për ruajtjen e një kopje të dosjeve fizike në një vend tjetër. Pra, këtu kemi laramani pasi që disa stacione policore dosjet fizike të personave të arrestuar i ruajnë vetëm në qendrën e mbajtjes, kurse disa stacione policore këto dosje i ruajnë edhe në një vend tjetër.

3.8.5 Vlen të theksohet që për rekomandimet të cilat kanë pasur implikime buxhetore, janë ndërmarrë hapat e duhur duke filluar me procedurat e prokurimit për renovimin e qendrave të mbajtjes. Pra, është bërë planifikimi i buxhetit për investimet e nevojshme, janë përgatitur specifikacionet teknike për punët të cilat duhet të kryhen përmes procedurave të prokurimit si dhe janë dorëzuar kërkesat në Drejtorin e Prokurimit për fillimin e procedurave të prokurimit. Por, për kundër faktit që procedurat e prokurimit për renovimin e qendrave të mbajtjes kishin filluar, gjendja në terren sa i përket kushteve në qendrat e mbajtjes nuk kishte pasur ndryshime për shkak të mos finalizimit të të gjitha punëve në përputhje me planifikimet.

3.8.6 Pra të gjitha rekomandimet të cilat janë adresuar pjesërisht janë të ndërlidhura me implikime buxhetore me procedurat e prokurimit, procedura këto që marrin kohë. Mirëpo ka indicie që këto rekomandime për një periudhë jo të largët do të kalojnë në rekomandime të adresuara plotësisht.

3.8.7 Realizimi i pjesshëm i rekomandimeve si dhe vonesat e mundshme për ti adresuar plotësisht rekomandimet që lidhen me kushtet materiale dhe aspektit të sigurisë në Qendrat e Mbajtjes mund të cenojnë disa të drejta elementare të personave që janë për një periudhë të caktuar në Qendrat e Mbajtjes.

Rekomandim nr. 8

IPK përshëndet të arriturat në implementimin e rekomandimeve të dhëna nga inspektimi “Inspektimi i performancës Policore së Njësisve Speciale Operative” dhe rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë që të vazhdoj të ketë si prioritet ushtrimin e kontrollit për tu siguruar që çështjet që lidhen me implikime buxhetore, të jenë të planifikuara në periudhat e caktuara kohore dhe për realizimin e tyre të jetë i njoftuar menjëherë.

3.9 Dhomat e Dëshmime në Policinë e Kosovës

3.9.1 Të gjeturat nga inspektimi *“Dhomat e Dëshmime në Policinë e Kosovës”* i cili është zhvilluar në vitin 2013, kishte treguar për mungesë të inventarit të nevojshëm për vendosjen e dëshmime si raftet lëvizëse, kontenier, frigorifer, shuarës zjarri etj. Në dhoma të dëshmime ishte konstatuar se ka lagështi, dyert e dhomave të dëshmime nuk ishin të sigurisë së mirë. Gjithashtu ishin evidentuar mangësi edhe sa i përket administrimit të dëshmime ku nuk ishin mbajtur shënimet në mënyrë ekuivalente si në librin e regjistrimit të dëshmime ashtu edhe në bazën e të dhënave elektronike, mandej, kishte raste kur nuk ishin plotësuar të gjitha rubrikat e parapara. Zyrtarët e dhomave të dëshmime nuk kishin të kryer ndonjë trajnim adekuat lidhur me menaxhimin dhe administrimin e dëshmime, gjithashtu nuk kishte të caktuar ndonjë zyrtarë alternativ për dhomat e dëshmime.

3.9.2 Duke u bazuar në të gjeturat e këtij inspektimi *“Dhomat e Dëshmime në Policinë e Kosovës”* i cili është zhvilluar në vitin 2013, IPK kishte dhënë dymbëdhjetë (12) rekomandime për mënyrën e evitimit të këtyre mangësive.

3.9.3 Të gjeturat nga ky inspektim përcjellës lidhur me implementimin e rekomandimeve të dala nga inspektimi *“Dhomat e Dëshmime në PK”* tregojnë se Policia e Kosovës në dhomat e dëshmime kishte bërë përmirësim të gjendjes sa i përket furnizimit me pajisjet si raftet, frigoriferët, shuarës zjarri, kuti standarde etj. Gjithashtu përmirësim të gjendjes kishte edhe sa i përket administrimit të dëshmime. Policia e Kosovës është përgjigjur në kohën më të shpejtë mundur në drejtim të implementimit të rekomandimeve që kanë dal si rezultat i të gjeturave nga ky inspektim. Nga gjithsej dymbëdhjetë (12) rekomandime, gjashtë (6) nga to janë adresuar plotësisht, pesë(5) nga to janë adresuar pjesërisht, dhe një (1) nga to nuk është adresuar ende.

3.9.4 Menaxhmenti i lartë i PK-së ka arrit që plotësisht ti adresoj rekomandimet e IPK-së, që kanë të bëjnë me ngritjen e shkallës së sigurisë në dhomat e dëshmime, në paketimin dhe ruajtjen e dëshmime, në mbajtjen e shënimeve në mënyrë ekuivalente si në librin e evidencave ashtu edhe në formë elektronike. Gjithashtu, adresim i plotë i rekomandimeve të IPK-së është arrit edhe sa i përket përpilimit të PSO-së *“Dhoma e Dëshmime”*, është ngritë niveli i mekanizmave të kontrollit duke kryer inspektime, inventarizimit dhe raportimeve. Është arrit që në të gjitha dhomat e dëshmime të aplikohet data baza elektronike. Ndërsa në dhomën e dëshmime DRP- Ferizaj është arrit që të eliminohet lagështia.

3.9.5 Po ashtu dhoma qendrore e dëshmime, dhoma e dëshmime Prizren, dhoma e dëshmime Ferizaj, Pejë, Mitrovicë, në përgjithësi kanë të përmbushura pesë objektivat e përcaktuara e që kanë pasur të bëjnë me vendosjen, trajtimin dhe ruajtjen , sigurinë, paketimi-shënimet, dhe evidentimin e dëshmime në dhoma.

3.9.6 Menaxhmenti i lartë i PK-së, pjesërisht ka adresuar rekomandimet që kanë të bëjnë me paraqitjen e informacioneve lidhur me vendndodhjen (lokacionin e saktë të deponimit) e dëshmime si dhe sa i përket furnizimit me qese letre me shënime në gjuhët zyrtare. Gjithashtu nuk është arritur që në plotësi të adresohet çështja e trajnimeve për zyrtarët policor të dhomave të dëshmime, duke bërë që një numër i konsiderueshëm i tyre të ndjek trajnimin që ka pasur për temë dhomat e dëshmime.

3.9.7 Po ashtu menaxhmenti i lartë i PK-së edhe pse ka ndërmarrë hapa në drejtim të furnizimit të dhomave të dëshmime me pajisjet e nevojshme, dhoma e dëshmime ne Prishtinë dhe Gjilan janë të vendosura në vende të papërshtatshme, kane hapësira jo të mjaftueshme, kanë lagështi si dhe kanë mungesa të rafteve për vendosjen e dëshmime.

3.9.8 Vlen të theksohet që të gjitha dhomat e dëshmime në veçanti ju mungojnë disa nga pajisjet të cilat lidhen me mbarëvajtjen e punës siç janë : spërkatësi i zjarrit, dhe kontenier të posaçëm. Ndërsa rekomandimi i pa adresuar mbetet trajnimi i zyrtarëve policor alternativ për dhomat e dëshmime.

3.9.9 Vendet e papërshtatshme, hapësirat e pa mjaftueshme dhe lagështia në dhomat e dëshmime, mund të rrezikojnë dëshmitë si prova materiale dhe do ta bënin të papranueshme procedurën e mëtutjeshme dhe e cila lidhet me vargun e një sistemi të tërë të drejtësisë. Ndërsa mungesa e disa pajisjeve rrezikon ta bënte të pamundur respektimin e rregullave të përcaktuara nga ana e PK-së, që konkretisht kanë të bëjnë me dokumentet që rregullojnë dhomat e dëshmime.

Rekomandim nr. 9

IPK përshëndet të arriturat në implementimin e rekomandimeve të dhëna nga inspektimi "Dhomat e Dëshmime në Policinë e Kosovës", dhe rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë që të vazhdoj të ketë si prioritet çështjen e dhomave të dëshmime, duke u siguruar se drejtoritë përgjegjëse janë angazhuar që në ato regjione ku gjendja e dhomave të dëshmime nuk është e përshtatshme dhe nuk i përmbush nevojat të gjejnë hapësira tjera ku mund ti vendosin dhomat e dëshmime, si dhe të furnizohen me pajisjet që i parasheh baza ligjore që rregullon dhomat e dëshmime. Po ashtu Drejtori i Përgjithshëm i Policisë duhet të sigurohet që të gjitha drejtoritë rajonale, stacionet policore që kanë të funksionalizuara dhomat e dëshmime të trajnojnë zyrtarët policor alternativ për dhomat e dëshmime.

3.10 Vlerësimi i Performancës , Gatishmërisë, Trajnimeve dhe Kushteve të Punës në NJSI-së

3.10.1 Të gjeturat nga inspektimi "Vlerësimi i performancës, gatishmërisë, trajnimeve dhe kushteve të punës në NJSI" i cili është zhvilluar në vitin 2013, kishte treguar se NJSI ballafaqohet me mungesë të personelit të graduar ku si pasojë e kësaj mungese nuk ishin plotësuar pozitat konform strukturës organizative. Megjithëse, udhëtimi për pjesëtarët e NJSI-së ishte i organizuar përmes automjeteve në thirrje, numri i automjeteve në thirrje nuk ka qenë i mjaftueshëm dhe nuk janë përfshirë të gjithë zyrtarët policor. Sa i përket çështjes së trajnimeve për personelin e NJSI-së duhet theksuar se nuk ishte përmbushur plotësisht plani i trajnimeve, ndërsa për trajnimet jashtë vendit kishte raste kur nominimet nuk kishin shkuar përmes Departamentit të Trajnimeve. Siguria në kampin "Vrella" nuk ishte në nivelin e kënaqshëm, pasi që rrethoja e kampit në disa vende ishte e dëmtuar.

3.10.2 Duke u bazuar në të gjeturat e inspektimit "Vlerësimi i performancës, gatishmërisë, trajnimeve dhe kushteve të punës në NJSI" i cili është zhvilluar në vitin 2013 , IPK kishte dhënë tetë (8) rekomandime për mënyrën e evitimit të këtyre mangësive.

3.10.3 Të gjeturat nga ky inspektim përcjellës lidhur me implementimin e rekomandimeve të dala nga inspektimi “*Vlerësimi i performancës, gatishmërisë, trajnimeve dhe kushteve të punës në NJSI*” tregojnë se menaxhmenti i Divizionit të Njësive të Specializuara ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për të implementuar rekomandimet që kanë dal nga ky inspektim i IPK-së. Nga gjithsej tetë (8) rekomandime, pesë (5) nga to janë adresuar plotësisht, kurse tri (3) nga to janë adresuar pjesërisht.

3.10.4 Gjatë intervistave me zyrtarët kompetent të NJSI-së, inspektorët kanë arrit të konstatojnë se puna në kuadër të NJSI-së është mjaftë mirë e organizuar duke u përkujdesur që të arrihen rezultate të mira si në kohën e mobilizimit dhe reagimit në përgjigje të rasteve dhe operacioneve, ruajtjen/fshehjen e identitetit të operatorëve gjatë operacioneve, të kujdeset që pajisjet që ka në përdorim kjo njësi të jenë të kualitetit të lartë dhe në gjendje të mirë.

3.10.5 Sa i përket aktiviteteve trajnuese për personelin e kësaj njësie, të gjeturat e inspektimit tregojnë se janë ndërmarr hapa konkret në sigurimin e kushteve për trajnime. Në fushën tekniko-taktike të trajnimit në kuadër të kësaj njësie tani ka instruktor të kualifikuar, kurse për ngritjen e aftësive fizike është ndërtuar palestra për stërvitje e cila është e pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme.

3.10.6 Lidhur me rekomandimin e dhënë nga IKSHPK si dhe ngritja e nivelit të sigurisë në kampin “Vrella”, të gjeturat e këtij inspektimi përcjellës tregojnë se këto rekomandime janë zbatuar plotësisht në praktikë, pasi që janë funksionalizuar dush kabinat, janë rregulluar të gjitha nyjet sanitare, nuk mungon furnizimi me materiale higjienike etj. Kurse sa i përket ngritjes së nivelit të sigurisë në Kampin “Vrella”, gjithashtu mundë të konsiderojmë se ky rekomandim është adresuar plotësisht pasi që është rregulluar rrethoja e kampit, ndriçimi është i mirë si dhe ekziston sigurimi fizik 24 orë në ditë. Po ashtu edhe shkallët emergjente janë në procesin e montimit.

3.10.7 Policia e Kosovës pa dyshim që është përballur me sfida sa i përket rekomandimeve të cilat ka arritur ti adresojnë pjesërisht, dhe çështje e potencuar në veçanti mbetet plotësimi i pozitave me personel të graduar konform strukturës organizative të PK-së. Vlen të theksohet se zhvillimi i procesit të gradimit për personelin policor përmes konkurseve është indicie e mirë që menaxhmenti i ka ndërmarr të gjithë hapat e nevojshëm dhe konkret drejt plotësimit të të gjitha pozitave me personelin me gradat adekuate për të gjitha sektorët e PK-së duke përfshirë edhe NJSI-në, por që NJSI ende nuk ka arritur që në plotësi të përmbushë pozitën e graduara në harmoni me strukturën organizative.

3.10.8 Nga inspektimi i kësaj fushe del në pah se organizimi i punës në këtë njësi ende është i organizuar në dy ndërrime, megjithëse rekomandimi i IPK-së kishte qenë që kjo njësi punën e saj ta organizoj në tri ndërrime. Gjithashtu, gjatë inspektimit Inspektorët kanë vërejtë se pjesëtarët e NJSI-së nuk furnizohen me rroba civile gjegjësisht me veshje sportive të cilat janë të nevojshme për stërvitje. Lidhur me mospërmbushjen e këtyre pjesëve të rekomandimeve inspektorët gjatë intervistave kanë marrë arsyetimet se nuk është e nevojshme organizimi i punës në tri ndërrime pasi që përgjigjet në raste janë mjaftë të shpejta si dhe organizimi i punës në tri ndërrime kërkon

numër më të madh të personelit. Kurse sa i përket furnizimit me veshje sportive këtu ka implikime buxhetore kështu që çdo zyrtarë i kësaj njësie duhet ti ketë veshjet personale sportive.

3.10.9 Shkëputjet zinxhirore të gradave, koha e mobilizimit dhe trajtimi i personelit të kësaj njësie ka gjithnjë potencial që të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejt në aspektin e përgjegjësive, llogaridhënies, dhe performacës të kësaj njësie.

Rekomandim nr. 10
IPK përshëndet të arriturat në implementimin e rekomandimeve të dhëna nga inspektimi <i>“Vlerësimi i performancës, gatishmërisë, trajnimeve dhe kushteve të punës në NJSI”</i> dhe rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë që të vazhdoj të ketë si prioritet çështjen e shpërndarjes së burimeve njerëzore duke u siguruar se NJSI-se ka përmbushur strukturën organizative të saj duke plotësuar pozitat me gradat e parapara.

4. VERIFIKIMI I PËRPJËKJEVE ORGANIZATIVE DHE PLANIFIKUESE NË DREJTIM TË IMPLEMENTIMIT TË REKOMANDIMEVE NGA MENAXHMENTI I LARTË I PK-SË

4.1 Bazuar në strukturën organizativë të PK-së, të datës 17.05.2012 menaxhmenti i lartë i PK-së është i organizuar në mënyrë të tillë që në krye të organizatës qëndron Drejtori i Përgjithshëm i PK-së, i cili në vartësi të tij ka Zëvendës Drejtorinë e Përgjithshëm për Operativë (ZDPO) dhe Zëvendës Drejtorinë e Përgjithshëm për Resurse (ZDPR). Ndërsa derisa ZDPO udhëheq me tri departamente të saj e të cilat ndahen në Departamentin për Operacione, Departamentin për Hetime dhe Departamentin për Kufi, ZDPR udhëheq me Departamentin e Personelit dhe Departamentin për Shërbime Mbështetëse. Në vartësi të Drejtorit të Përgjithshëm i PK-së, përveç të një numri të drejtorive specifike gjendet dhe drejtoria për Auditime dhe Inspektime në PK-së.

4.2 Niveli i lartë menaxherial i PK-së, ka arritur të prezantoj që për të gjitha rekomandimet e IPK-së, ka bërë angazhime konkrete për të implementuar rekomandimet që kanë dal nga inspektimet e IPK-së, duke i veshur me përgjegjësi udhëheqësit e atyre drejtorive ndaj të cilave është paraqitur e gjetura në raportin konkret.

4.3 Deri në periudhën kur edhe po prezantohen këto të gjetura Menaxhmenti i lartë i Policisë së Kosovës, brenda vetë organizatës nuk ka arritur të krijojë grupe apo komisione të fushave të veçanta të cilët në mënyrë të posaçme do të përcjellin implementimin e rekomandimeve të dala qoftë nga IPK-së, ose organizata tjera, të cilat angazhohen në drejtim të dhënies së rekomandimeve për përmirësimin e performancës policore.

4.4 Gjithashtu drejtoria për Auditime dhe Inspektime si mekanizëm i kontrollit të brendshme në Policinë e Kosovës, është angazhuar që të inspektojë fusha të ndryshme nga të cilat më pastaj ka përpiluar raporte me të gjeturat nga inspektimi. Por, kjo drejtori nuk ka arritur të krijojë programe të punës inspektuese përmes së cilave pas një periudhe pasuese nga raporti i dalë prej IPK-së, të përcjellë implementimin e rekomandimeve duke ju qasur në auditim-inspektim fushës së njëjtë inspektuese me IPK-së.

4.5 Organizimi dhe Planifikimi i këtillë i PK-së, për të ju qasur implementimit të rekomandimeve, ka bërë që menaxhmenti i lartë të mos arrijë të marrë informacionin kthyes, përmes të cilit do të ishte në dijeni për gjendjen dhe rrjedhën e implementimit të rekomandimeve.

4.6 Inspektorati Policor i Kosovës konsideron se Policia e Kosovës edhe përkundër përpjekjeve konkrete në implementimin e rekomandimeve të IPK-se ka nevojë që të hartoj plane konkrete në nivel qendror për të analizuar dhe përcjell rrjedhën e implementimit të rekomandimeve të IPK-së duke marr informatat e duhura kthyes në kohe në mënyre që vendimmarrja dhe veprimi të jetë më konkret dhe më i shpejt. Kjo krijon mundësinë që Policia e Kosovës gjatë planifikimit vjetor të punës së saj të vendosë më lehtë prioritetet e saj të cilat do ti shpërndaj sipas përgjegjësis strukturore për implementim dhe përcjellje.

5. IDENTIFIKIMI SFIDAVE DHE PENGESAVE ME TË CILAT ËSHTË PËRBALLË PK-JA, NË DREJTIM TË IMPLEMENTIMIT TË REKOMANDIMEVE

5.1 Policia e Kosovës si një organizatë relativisht e re, që nga themelimi i saj është ballafaquar me shumë sfida si në aspektin konceptual të ndërtimit të saj organizative po ashtu edhe në aspektin profesional, legjislativ dhe buxhetor. Si organizatë e re ajo është në vazhdimësi në proces të reformave duke ndjekur ndryshimet e përgjithshme sociale, ekonomike dhe legjislativ. Siç dihet Policia e Kosovës ka një strukturë komplekse organizative pasi në përbërjen e saj ka një llojllojshmëri të detyrave dhe përgjegjësive të cilat kanë për qëllim mbrojtjen dhe sigurinë e qytetarëve të Kosovës dhe rendit kushtetues të saj nga çfarëdo kërcënimi.

5.2 Bazuar në përbërjen e vetë strukturore, Policia e Kosovës ka mbi 8 mijë punonjës dhe si e tillë është e natyrshme që të përballë me sfida dhe pengesa në kryerjen në përpikëri të disa detyrave të cilat po ashtu natyrshëm ndërlihdën me faktorët e lartpërmendur.

5.3 Sfidat të cilat kanë përcjell PK-së në implementimin e rekomandimeve, bazuar në intervistat e marra nga menaxhmenti më i lartë i PK-së dhe në bazë të argumenteve të arsyeshme janë përcjell nga çështjet financiare, prokurimit, të cilat në vetë vetë nuk varën nga punët e drejtpërdrejta policore, por nga ligjet të cilat burojnë nga institucionet tjera e për të cilat PK-ja, është e pafuqishme.

5.4 Shumicën e rekomandimeve të IPK-së, PK nuk ka arritur që të implementojë pikërisht për shkak të procedurave të prokurimit, nga të cilat më pastaj është varur edhe rrjedhshmëria e ndërmarrjes së hapave konkret për ti realizuar këto rekomandime në plotësi ose që për afërsisht të jenë të implementuar në nivelin e pjesshëm.

5.5 Po ashtu Policia e Kosovës është përballur me çështjen e gradimit të zyrtarëve policor të cilat procese përballën me procedura që zgjasin me periudha të gjata kohore si dhe me shumë implikime buxhetore. Të gjitha këto më pastaj kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejt me sfidat që PK-së është përballur me shpërndarjen e personelit në përputhshmëri (harmoni) me strukturën organizative.

5.6 Edhe për kundër faktit që Policia e Kosovës në planifikimet e saj ka realizuar investime kapitale me qëllim të krijimit të infrastrukturës së re, trashëgimi i një infrastrukture të vjetër, ku janë të vendosura njësitë e ndryshme të Policisë së Kosovës përbën një sfidë apo pengesë tjetër në realizimin me përpikëri të rekomandimeve. Siç dihet shumë njësi ende janë në stacionet e vjetra policore dhe si të tilla nuk ofrojnë kushtet që duhen për policim modern për të cilat është e angazhuar Policia e Kosovës dhe Inspektorati Policor

6. PËRFUNDIMET

6.1 Inspektorati Policor i Kosovës ka vlerësuar angazhimin e Policisë së Kosovës drejt implementimit të rekomandimeve që kanë dal nga fushat inspektuese të periudhës 2012-2013. Duhet theksuar që PK i ka dhënë një rendësi të veçantë implementimit të rekomandimeve të dala nga IPK duke ndjerë përgjegjësinë dhe duke shprehur përkushtimin e tyre në takimet përmbyllëse që janë zhvilluar në mes PK-së dhe IPK-së.

6.2 Menaxhmenti i lartë i PK-së, secili në fushën e vet, ka arritur që në këto takime të prezantojë dokumentacionet relevante që kanë qenë pjesë e nevojave për të argumentuar nivelet e implementimit të rekomandimeve. Nga kjo është identifikuar dukuria e mungesës së një komunikimi të ndërsjellë në mes të niveleve dhe funksioneve të ndryshme menaxheriale pasi që shumë dokumente të prezantuara në këto takime, nivelet dhe funksionet e inspektuara nuk kishin arrite që ti prezantonin.

6.3 Me gjithë se Policia e Kosovës në tërë strukturën e saj organizative ka të instaluar një mori mekanizmash të kontrollit të brendshëm, ato nuk kanë arritur të kenë funksionim të planifikuar për të pasur vazhdimisht nën kontroll gjendjen e njësive të caktuara e të cilat kanë qenë objekt inspektimi, dhe e cila çështje mund të shkaktojë dobësi në performancën dhe efikasitetin e detyrave të përditshme policore.

6.4 Policia e Kosovës ka treguar angazhime konkrete me qëllim të respektimit të strukturës organizative në fuqi. Por edhe për kundër këtyre angazhimeve ende nuk është arritur që të ketë realizim të plotë të strukturës organizative, duke bërë që në disa raste të ketë jo standardizim të shpërndarjes së burimeve njerëzore në nivelin e gradave e të cilat PK i posedon.

6.5 Policia e Kosovës ka të krijuar infrastrukturë ligjore për të gjitha njësitë dhe natyrën e punëve. Mirëpo në disa çështje është vërejtur se ka mangësi sa i përket krijimit të formularëve (shkresave) të cilat kanë lënë hapësira në krijimin e argumenteve për angazhimin e secilës njësi në fusha të ndryshme.

6.6 Policia e Kosovës, konkretisht Departamenti për Kufi është angazhuar në drejtim të implementimit të rekomandimeve, por adresimin e plotë të tyre nuk ka arritur ta mbajë në mënyrë të njëjtë në të gjitha drejtoritë rajonale të policisë kufitare.

6.7 Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse edhe për kundër angazhimeve të mirëfillta nuk ka arritur që të furnizojë flotën operative me automjete të reja, si dhe nuk ka vënë në funksion kontrollin teknik pranë flotës operative. Po ashtu nuk është arritur që të bëhet kontrollimi teknik (periodik) i automjeteve të PK-së, në përputhje me kërkesat që i ka të parashtruara baza ligjore.

6.8 Policia e Kosovës në të gjitha njësit e saj i funksionojnë data baza përmes së cilave futen të dhënat konkrete por, mungesa e qasjes së plotësisimit të të dhënave nga të gjitha njësit në një data bazë të unifikuar ka shkakuar diferenca të të dhënave.

6.9 Rekomandimet që nuk kanë arritur të adresohen e për të cilat menaxhmenti i lartë i PK-së, ka përcjell përgjegjësitë deri tek njësitë me qëllim të implementimit të rekomandimeve të dala

nga fushat inspektuese të cilat janë vënë në lëvizje me qëllim të adresimit të rekomandimeve. Mirëpo për kundër këtyre angazhimeve në disa rrethana PK, nuk ka arritur që ti adresojë në plotësi rekomandimet për shkak të implikimeve ligjore që kanë rrjedhur nga procedurat e prokurimit e të cilat krijojnë rrethana të kundërta me angazhimet për të implementuar rekomandimet.

7. REKOMANDIMET

1. IPK përshëndet të arriturat në implementimin e rekomandimeve të dhëna nga inspektimit “Identifikimi dhe vlerësimi i procedurave të Arrestim - Ndalimit në Policinë e Kosovës” dhe rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë që të vazhdoj të ketë prioritet veprime konkrete duke zhvilluar inspektime, në mënyrë që të mbajë nën kontroll çështjen e kompletimit-harmonizimit, plotësimit, përmbledhjes (radhitjes) së formularëve të Arrestim- Ndalimit përmes mekanizmave të mbikëqyrjes dhe kontrollit të brendshëm siç është zyra e Auditimit të Brendshëm, Inspektimit dhe njësitë tjera relevante.
2. IPK përshëndet të arriturat në implementimin e rekomandimeve të dhëna nga inspektimit “Ekzekutimi i urdhëresave dhe letër-rreshtimeve nga Policia e Kosovës – Stacioni Policor Gjakovë” dhe rekomandon Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm për Operativë dhe Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm për Resurse të kenë prioritet formimin e grupeve të cilat do të japin propozimet përmes së cilave do të krijoheshin formularë (shkresa) të cilat do të adresonin në mënyrë konkrete rastet e takimeve dhe bashkëpunimeve në mes njësive brenda PK-së, si dhe institucioneve tjera.
3. IPK përshëndet të arriturat në implementimin e rekomandimeve të dhëna nga inspektimit “Menaxhimi i Policisë Kufitare” dhe rekomandon Udhëheqësin e Departamentit për Kufi dhe udhëheqësin e Divizionit i Kontrollit dhe Mbikëqyrjes të Kufirit që të vënë në prioritet që adresimi i rekomandimeve të përcillet në mënyrën e njëjtë në të gjitha drejtoritë rajonale të policisë kufitare.
4. IPK përshëndet të arriturat në implementimin e rekomandimeve të dhëna nga inspektimit 2012 “Kryerja e detyrave policore në planifikimin, furnizimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e Flotës Operative të Policisë së Kosovës” dhe rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë të vazhdoj të ketë si prioritet që Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse, të ndërmarrë hapat konkret me qëllim të furnizimit të PK-së me automjete të reja, të bëjë funksional kontrollin teknik në flotën operative si dhe të sigurohet që infrastruktura ligjore që rregullon çështjen e kontrollës teknike të jetë e zbatueshme.
5. IPK përshëndet të arriturat në implementimin e rekomandimeve të dhëna nga inspektimi “Vlerësimi i procedurave të hetimit të rasteve të aksidenteve të trafikut në Policinë e Kosovës” dhe rekomandon Udhëheqësit e Divizionit të Komunikacionit Rrugor, komandantët e NJRKRR-ve, të kenë në prioritet angazhimin e tyre në përpilimin e dokumenteve të cilat do të dalin si të unifikuara, si dhe do të realizojnë një kontroll më të rreptë sa i përket kompletimit të të gjithë dosjes së rasteve të punuara nga zyrtarët policorë të NJRKRR-ve.
6. IPK përshëndet të arriturat në implementimin e rekomandimeve të dhëna nga inspektimi “Vlerësimi i Shpërndarjes së Personelit në PK” dhe rekomandon Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë që të vazhdoj ta ketë prioritet çështjen e shpërndarjes së personelit e cila duhet të bëhet në përputhshmëri të plotë me rregulla të qarta të shpërndarjes së personelit ekzistues. Ndërsa, drejtorët e departamenteve duhet të angazhohen duke kontribuar në dhënien e ideve dhe zhvillimin e bashkëpunimit me të

gjitha njësitë për të mundësuar krijimin e një data baze e cila në mënyrë të unifikuar do të prezantonte të dhënat e të gjitha niveleve të PK-së.

7. IPK përshëndet të arriturat në implementimin e rekomandimeve të dhëna nga inspektimi *“Inspektimi i performancës Policore së Njërive Speciale Operative”* dhe rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë të vazhdoj të ketë si prioritet që burimet njerëzore me të cilat posedon e të cilat i përmbushin nevojat e shpërndarjes së tyre të bëhen në përputhshmëri me gradat dhe trajnimet adekuate.
8. IPK përshëndet të arriturat në implementimin e rekomandimeve të dhëna nga inspektimi *“Inspektimi i performancës Policore së Njërive Speciale Operative”* dhe rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë që të vazhdoj të ketë si prioritet ushtrimin e kontrollit për tu siguruar që çështjet që lidhen me implikime buxhetore, të jenë të planifikuara në periudhat e caktuara kohore dhe për realizimin e tyre të jetë i njoftuar menjëherë.
9. IPK përshëndet të arriturat në implementimin e rekomandimeve të dhëna nga inspektimi *“Dhomat e Dëshmime në Policinë e Kosovës”*, dhe rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë që të vazhdoj të ketë si prioritet çështjen e dhomave të dëshmime, duke u siguruar se drejtoritë përgjegjëse janë angazhuar që në ato regjione ku gjendja e dhomave të dëshmime nuk është e përshtatshme dhe nuk i përmbush nevojat të gjejnë hapësira tjera ku mund ti vendosin dhomat e dëshmime, si dhe të furnizohen me pajisjet që i parasheh baza ligjore që rregullon dhomat e dëshmime. Po ashtu Drejtori i Përgjithshëm i Policisë duhet të sigurohet që të gjitha drejtoritë rajonale, stacionet policore që kanë të funksionalizuara dhomat e dëshmime të trajnojnë zyrtarët policor alternativ për dhomat e dëshmime.
10. IPK përshëndet të arriturat në implementimin e rekomandimeve të dhëna nga inspektimi *“Vlerësimi i performancës, gatishmërisë, trajnimeve dhe kushteve të punës në NJSI”* dhe rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë që të vazhdoj të ketë si prioritet çështjen e shpërndarjes së burimeve njerëzore duke u siguruar se NJSI ka përmbushur strukturën organizative të saj duke plotësuar pozitat me gradat e parapara.